

Hartimi i planit të punës për vitin 2016 të Strategjisë Qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile 2013-2017

Sekretariati i Platformës CiviKos në koordinim të vazhdueshëm me ZQM gjatë muajit Janar 2016 kanë organizuar takime me grupet e punës për katër objektivat strategjike, ku përpos aprovimit të raportit të punës rreth implementimit të Strategjisë Qeveritare gjatë vitit 2015, u vendos që katër grupet punuese gjatë muajit Shkurt 2016 të përpilojnë planin e punës për vitin 2016, duke e finalizuar në një takim të përbashkët me të gjithë anëtarët e Këshillit.


Takimet e grupeve të punës për hartimin e planit të punës për 2016, u mbajtën në Hotel Sirius dhe Emerald, gjatë muajit Shkurt 2016.

- 15.02.2016- Punëtorja për hartimin e planit të punës për objektivën e dytë.
- 16.02.2016 - Punëtorja për hartimin e planit të punës për objektivën e parë.
- 18.02.2016 - Punëtorja për hartimin e planit të punës për objektivën e tretë.
- 19.02.2016 - Punëtorja për hartimin e planit të punës për objektivën e katërt.
- 29.02.2016 - Punëtori e përbashkët e katër grupeve të punës për të finalizuar planin e punës për vitin 2016.



Përzgjedhja e anëtarëve të shoqërisë civile në Këshillin për zbatimin e strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile 2013-2017

Pas largimit të katër anëtarëve të shoqërisë civile nga Këshilli për Zbatimin e Strategjisë Qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile 2013-2017, Sekretariati i Platformës CiviKos me 23.02.2016 ka hapur thirrjen për përzgjedhjen e katër anëtarëve të shoqërisë civile në Këshill. Gjithsej janë nominuar 8 përfaqësues të shoqërisë civile, ku pas mbylljes së procesit të votimit me datë 11.03.2016, Sekretariati i CiviKos organizoi numërimin e votave. Në procesin e numërimit të votave, CiviKos ka ftuar në cilësinë e vëzhguesve përfaqësues të OSHC-ve, përfaqësues të medieeve, asociacione dhe rrjete të ndryshme që veprojnë në Kosovë si dhe përfaqësues nga Zyra e Kryeministrit/Zyra për Qeverisje të Mirë, si dhe Zyra për Regjistrimin e OJQ-ve Kosovë. Pas përfundimit të numërimit të votave në prani të vëzhguesve katër kandidatët që kishin marrë më së shumti vota, dhe që do të jenë përfaqësuesit e rinj në Këshill janë: Feride Rushiti nga Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT), Florina Dulaj – Sefaj nga Iniciativa Kosovare për Stabilitet (IKS), Furtuna Sheremeti nga Lëvizja FOL dhe Arton Demhasaj nga OJQ ÇOHU.



Përzgjedhja e anëtarit të shoqërisë civile në Komisionin për shqyrtim të aplikacioneve në Ministrinë e Integritit Evropian

Më kërkesë të Ministrisë së Integritit Evropian Sekretariati i Platformës CiviKos me datë 07.03.2016 ka hapur thirrjen për përzgjedhjen e përfaqësuesit të shoqërisë civile në Komisionin për shqyrtimin e aplikacioneve për subvencionimin e projekteve dhe aktiviteteve. Në komision është paraparë edhe një përfaqësues i shoqërisë civile i përcaktuar sipas Rregullores Nr. 01/2016 për Subvencionimin e Projekteve dhe Aktiviteteve që Promovojnë Procesin e Integritit Evropian të Republikës së Kosovës. Pas përfundimit të afatit për aplikim, pasi ishte vetëm një kandidat i nominuar, Arton Demhasaj nga organizata ÇOHU është emëruar si anëtarë nga shoqëria civile në këtë komision.

Takim informues me anëtarët e porsazgjedhur në Këshillin për Zbatimin e Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me shoqërinë civile 2013-2017

Sekretariati i Platformës CiviKos në bashkëpunim me ZQM gjatë muajit Mars 2016 takoi katër anëtarët e posa zgjedhur në Këshillin për Zbatimin e Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me shoqërinë civile. Anëtarët e rinj u njoftuan me punën e Këshillit, implementimin e strategjisë si dhe rolin e ZQM-së dhe Sekretariatit të CiviKos në koordinimin e punës së Këshillit dhe procesit të implementimit të strategjisë. Sekretariati i CiviKos i njoftoi për monitorimin paralel të implementimit të Strategjisë, si dhe mundësinë e shfrytëzimit të matricës së monitorimit, përgatitur nga Sekretariati i CiviKos.

Ndryshimet në Statut

Në Kuvendin e fundit të CiviKos në mënyrë që të rritet pjesëmarrja aktive e organizatave të shoqërisë civile në aktivitetet e Platformës CiviKos, gjatë kuvendit u propozuan dhe votuan ndryshimet në Statut të CiviKos respektivisht Neni 6.10 ku përcaktohet përjashtimi i organizatave anëtare për shkak të pasivitetit të anëtarëve dhe shtimi i nenit 10 – pagesa e anëtarësisë.

Pagesa e Anëtarësisë

Pas vendimit që të ketë pagesë anëtarësie në CiviKos me një shumë fikse prej 15 euro, gjatë muajit Shkurt 2016 Sekretariati i Platformës CiviKos ka përcjell instruksionet për pagesë të anëtarësisë, tek të gjitha organizatat anëtare ku dhe ka filluar pagesa e anëtarësisë për vitin 2016.

Përzgjedhja e anëtarit të ri të Bordit

CiviKos në Kuvendin e fundit, përmes votimit nga vetë anëtarët, përzgjedhi anëtarin e re të bordit Ariana Qosaj Mustafa nga organizata KIPRED.

Takim koordinues me koordinatorët e qendrave rajonale të CiviKos

Sekretariati i Platformës CiviKos me datë 24.02.2016 organizoi takim koordinues me koordinatorët e 5 Qendrave Rajonale të CiviKos, për të diskutuar rreth finalizimit të planit strategjik për tri vitet e ardhshme. Qendrat Rajonale të CiviKos do të vazhdojnë të shërbejnë si qendra avokuese dhe informuese të CiviKos në 5 rajonet e Kosovës, duke shtrirë dhe promovuar praktikën e bashkëpunimit mes shoqërisë civile dhe autoriteteve publike edhe në nivelin lokal.



Takim konsultativ me organizatat e shoqërisë civile – Regjistri i ri i OJQ-ve

Sekretariati i Platformës CiviKos në bashkëpunim me Ministrinë e Administratës Publike- Departamenti për Organizata Joqeveritare kanë organizuar takim konsultativ me organizatat e shoqërisë civile në Kosovë, ku u prezantua përmbajtja e Regjistrimit të ri të OJQ-ve, të regjistruara në Kosovë, i cili është duke u punuar nga Ministria e Administratës Publike- Departamenti për Regjistrim të OJQ-ve, si dhe obligimet e OJQ-ve ndaj këtij departamenti. Gjatë takimit u diskutua edhe përmirësimi i shërbimeve ndaj OJQ-ve.

Shpërndarja transparente e fondeve publike – Praktikat dhe modelet e mira të Bashkimit Evropian

Dardan Kryeziu nga Sekretariati i CiviKos morri pjesë në konferencën rajonale “Transparent Allocation of Public Funds – EU Good Practices and Models” (Shpërndarja transparente e fondeve publike – Praktikat dhe modelet e mira të Bashkimit Evropian) e cila u mbajt në Sarajevë nga 29.03.2016-01.04.2015, organizuar nga TACSO.

Gjatë konferencës u prezantuan modelet e disa shteteve të Bashkimit Evropian, si dhe u ndanë praktikat e ndarjes së fondeve publike për shoqëri civile nga vendet e Ballkanit perëndimor dhe Turqisë.

Transparenca në fonde publike është pjesë e Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me qeverinë 2013-2017, Objektiva e 3, ku po punohet së bashku me Qeverinë për përcaktimin e modelit të ndarjes së fondeve publike për OSHC-të në Kosovë.

Kontributi i CiviKos në validimin e indikatorëve në procesin e monitorimit të partneritetit global për bashkëpunim efektiv zhvillimor

Sekretariati i Platformës CiviKos gjatë muajit Mars morri pjesë në takimin rreth validimit të indikatorëve për shoqërinë civile në procesin e monitorimit të Partneritetit Global për Bashkëpunim Efektiv Zhvillimor, ku dha kontribut rreth procesit të bashkëpunimit shoqëri civile - Qeveri. Ky hulumtim është duke u realizuar nga organizata KCSF dhe do të jetë pjesë e hulumtimit global, ku për Kosovë do të prezantohen të gjeturat për indikatorin *Shoqëria Civile vepron në mjedis i cili e maksimizon angazhimin dhe kontributin e saj në zhvillim.*

Shërbimi informues i CiviKos

Sekretariati i CiviKos ka vazhduar me shpërndarjen e informatave për organizatat anëtare dhe joanëtare, përmes buletinit elektronik, web faqës si dhe medie sociale. Po ashtu gjatë periudhës Janar-Mars 2016 janë shpërndarë gjithsej 26 dokumente qeveritare për konsultim publik, si projektligje, udhëzime administrative, projekt-rregullore. Gjithashtu ka shpërndarë informata rreth mundësive të ndryshme për trajnime dhe grante.

Disa nga aktivitetet e Sekretariatit të CiviKos gjatë muajve Janar – Mars 2016

- Platforma CiviKos ka vazhduar me ngritjen e kapaciteteve tek stafi. Zyrtari për MVR, Dardan Kryeziu përfundoi trajnimin- Metodologjia Kërkimore dhe Aplikimi i Statistikës në SPSS, trajnim ky i organizuar nga BSCK dhe Ministria e Administratës Publike.
- Gjatë muajit Mars, Sekretariati i Platformës CiviKos morri pjesë në takimin e rregullt për iniciativën Kosova e Hapur, e cila iniciativë ka të bëjë me hapjen e të dhënave nga Qeveria e Kosovës. Hapja e të dhënave është iniciativë e KFOS dhe Ministria e Integritimit Evropian .
- Gjatë muajit Mars, Sekretariati i Platformës CiviKos morri pjesë në takimin e parë informues "Mbrojta e të drejtave të njeriut në epokën digjitale". Projekti është një përpjekje për të ngritur çështjen e të drejtave të privatësisë në komunikime elektronike dhe në medime digjitale. Ky takim u organizua nga organizata LENS.
- Gjatë muajit Mars, Sekretariati i Platformës CiviKos morri pjesë në publikimin e raportit *Raporti i Monitorimi të Kuvendit për vitin 2015*, raport i publikuar nga KDI.
- Gjatë muajit Mars, Sekretariati i Platformës CiviKos morri pjesë në prezantimin e raportit të monitorimit për Komunën e Skenderajt përgatitur nga organizata CBM.